

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRË
Nr. / Nr. 22125/25
Për. i Gj. / Për. st. -9-
Data: / Datumi: 20.05.25
VUSHTRRI - VUČITRË



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrië
Opština Vučitrë – Municipality of Vushtrri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 80/25, 19/05/2025

PROCESVERBAL

**nga mbledhja e katër e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 11 prill 2025
në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:15.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Mentor Hasani, Nurie Halili, Mensur Kasumi, Adnan Lahu, Fakete Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Agron Perçuku.

Gjithashtu, në këtë mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë. Ajo tha se na kanë ardhur edhe katër pikë shtesë për t'i shtuar në rend të ditës, të cilat pastaj drejtori i kadastrit do t'i sqarojë:

- Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rr. "Shahin Krasniqi" në Vushtrri;
- Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rr. "Isa Boletini" dhe sheshit "Hasan Prishtina" në Vushtrri;
- Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rr. "Gj.K. Skënderbeu" në Vushtrri;
- Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës- ri rregullim të kufirit të pronës tek SHMU "Ali Kelmendi" në Vushtrri sipas gjendjes faktike.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjcodezi, Kadastër dhe Pronë – sqaroi se propozimi në rr. "Gj.k.Skënderbeu" e ka edhe vlerësimin nga ministria. Kurse, për tri propozimet tjera jemi duke i pritur vlerësimet. Nëse nuk e kemi vlerësimin deri në kuvend, atëherë i heqim nga rendi i ditës.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se këto pika shtesë është dashur të na vijjnë me kohë, sepse është njëra prej pikave më të ndjeshme. Është rasti i peticionit në Reznik, ku u

vumë në lajthitje, duke mos qenë mjaftueshëm të informuar. Çështja e pronave është e ndjeshme, ku shpeshherë i prek edhe pronat private. Në rastin konkret, nuk e dimë a po krijojmë konteste apo zgjidhje, sepse nuk kemi informacione të mjaftueshme. Së paku 3-4 ditë më herë është dashur të na dërgohen. Po e presim materialin të na vjen dhe të diskutojmë.

Adnan Lahu, anëtar i KPF-së – në praktikat e mëhershme çështjet e tilla na kanë ardhur direkt në mbledhjen e kuvendit. Prandaj, mirë që kanë ardhur në KPF. Ai kërkoi që në mbledhjen e kuvendit të prezantohen përmes projektorit këto pika. Nëse janë të kompletuara ne do t'i përkrahim.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për” vendosi që të shtohen në rend të ditës pikat shtesë.

Komiteti për Politikë dhe Financa me gjashtë (6) vota “për” aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17.03.2025;
2. Raport tremujor për të hyrat dhe shpenzimet e komunës së Vushtrrisë për vitin 2025;
3. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rr. “Shahin Krasniqi” në Vushtri;
4. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rr. “Isa Boletini” dhe sheshit “Hasan Prishtina” në Vushtri;
5. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rr. “Gj.K. Skënderbeu” në Vushtri;
6. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës- ri rregullim të kufirit të pronës tek SHMU “Ali Kelmendi” në Vushtri sipas gjendjes faktike;
7. Pyetje dhe përgjigje.

1. Miratimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17.03.2025.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – në faqen 6 ku kemi diskutuar me kryetarin e komunës. Kur kryetari ka thënë që librin, të cilin e ke propozuar ti nuk është punim shkencor, por veç mbledhje e informatave. Kjo pjesë nuk është përfshirë. Ka dhjetëra herë që në procesverbale nuk përfshihen diskutimet. Andaj, për këtë mbahet procesverbali, që është i paraparë me ligj dhe të ruhet. Ndoshta, pas 100 viteve vjen dikush e hulumton dhe duhet të jetë i përfshirë diskutimi i secilit. Prandaj, po kërkoj që të shtohet ajo pjesë te fjalimi i kryetarit të komunës.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – nuk ma diçka konkrete tek procesverbali, sepse e kuptoj edhe Bujarin edhe Bastriun që e kanë një punë të vështirë. Vërejtja imë në aspektin teknik është te zërimi, ku kualiteti është shumë i dobët. Mbledhjet e kuvendit janë bërë

shumë vështirë të kuptueshme për audiencën, për shkak të kualitetit të zërit. Nuk është investim i madh rregullimi i zërimit nga ana e komunës. Disa vite e kemi planifikuar që të bëhet rregullimi i sallës komplet, nuk ndodhi. As votimi elektronik nuk u bë. Por, së paku një zërim kualitativ ta kemi në kuvend.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – pajtohem plotësisht sa i përket kualitetit të zërimit. Disa herë kemi bërë kërkesë për rregullimin e tij. Tani nuk po e kërkojmë as sallën, as votimin elektronik, por të paktën kualiteti i zërimit të rregullohet.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 26.03.2025 me ndryshime.

2. Raport tremujor për të hyrat dhe shpenzimet e komunës së Vushtrrisë për vitin 2025.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se në mbledhjen e kaluar kam kërkuar një raport nga drejtoritë përkatëse për drekat zyrtare, sidomos për iftare, por edhe në periudhën para muajit të Ramazanit, i cili nuk më është përcjellë. Konsideroj se buxheti është keqpërdor, jo keqpërdorim klasik, por shfrytëzim i buxhetit për qëllime tjera. Ku dhjetëra mësimdhënësve dhe kategorive tjera të zyrtarëve u janë ofruar dreka për qëllimet tjera, por edhe gjatë muajit të Ramazanit, ku të njëjtat shpenzime për dreka nuk po i shoh në raport. A është bërë me qëllim apo pa qëllim këtë nuk e di. Prandaj, kërkoj që deri në seancë këtë raport të bashkëngjiten edhe shpenzimet për dreka zyrtare dhe të detajohet periudha janar-mars 2025, si dhe nëse ka mundësi të shkoqitet periudha e iftareve. Ramazani është solidaritet, e jo zhvatje. Kryetari i komunës është bërë shumë dorëshlirë duke u jep iftare zyrtarëve të të gjitha kategorive me para të komunës.

Ai kërkoj sqarime për disa kode buxhetore, sepse siç tha ka një diskrepancë të madhe statistikore në raport me vitin paraprak. Kodi 13143 – shpenzimet tjera e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, ku në vitin 2024 kanë qenë 147€, kurse në periudhën e njëjtë të vitit 2025 janë 2,378.00€.

Kodi 13320 – shpenzimet e telefonisë mobile, ku në vitin 2024 kanë qenë 6,681.82€, kurse në periudhën e njëjtë të vitit 2025 janë 10,795.97€, mbi 4000 mijë euro më tepër. A është zgjeruar numri i zyrtarëve që komuna i subvencionon me mbushje telefonike, apo ku është problemi?

Kodi 13430 – shërbime të ndryshme shëndetësore, çka përfshihet në këtë kod? Ne e kemi grantin për shëndetësi edhe QKMF-në që ofron shërbime shëndetësore, ku komunat nuk kanë kompetencë jashtë shërbimeve që përfshihen me udhëzim administrativ për kujdes parësor. Andaj, prej 1,708.98€ në 4,584,94€ me kënd është kjo kontratë dhe çfarë shërbimesh janë blerë?

Kodi 13440 – shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse, prej 1,799.00€ në 4,607,45€ çfarë shërbimesh intelektuale dhe këshilldhënëse janë blerë? Kush janë këta intelektualë që i ka angazhuar komuna? Cili ka qenë kontributi i tyre në këshilldhënie?

Kodi 13460 – shërbime kontraktuese tjera, ku në vitin 2024 kanë qenë 794,289.97€, kurse në periudhën e njëjtë të vitit 2025 janë 1,715,542.48€. Pra, kemi rreth 1 milion euro shpenzime më tepër se në vitin paraprak. Çfarë shërbime janë këto? Çka është kjo diskrepancë kaq e madhe?

Kodi 13470 – shërbime teknike, nga 43.05€ kemi kaluar në 9,061.38€. Çka përfshihet në këto shërbime?

Kodi 13480 shpenzimet e anëtarësimit, nuk kam dëgjuar asnjëherë për këtë kod. Zero euro ka qenë vitin e kaluar, kurse në vitin 2025 kemi 25,240.25€. Çka përfshijnë këto shërbime të anëtarësimit?

Kodi 13509 pajisjet e tjera, zero euro ka qenë vitin e kaluar, kurse në vitin 2025 kemi 17,855.00€.

Kodi 13620 furnizim me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare), në vitin e kaluar kanë qenë 10,715.65€, kurse në vitin 2025 kemi 16,852.75€. E di që çmimet e ushqimeve po rriten vazhdimisht, por ky dallim është përtej formave të inflacionit.

Kodi 13630 – furnizime mjekësore, në vitin e kaluar kanë qenë 21,672.43€, kurse në vitin 2025 kemi 9,362.51€. Do kishte qenë e kuptueshme nëse furnizimet mjekësore ishin rritur, por këtu kemi zvogëlim. Pra, është rritur lluksi, e është zvogëluar mirëqenia, kurse në QKMF ka shumë mungesa, sepse vazhdimisht marrë ankesa nga pacientët.

Kodi 13710 – vaji, nuk e di për çfarë vaji e keni fjalën, a është vaj i veturave, nxemjeve apo vaj i ushqimit, zero euro ka qenë vitin e kaluar, kurse në vitin 2025 kemi 9,000.00€.

Kodi 13760 – dru dhe prodhimet e drurit për ngrohje, në vitin e kaluar kanë qenë 115,699.00€, kurse në vitin 2025 kemi 195,681.36€. Kjo është pasojë e kontratës skandaloze që e ka bërë kryetari dhe po shihen dëmet, ku kemi 80 mijë euro më shumë.

Kodi 13820 – avanc për udhëtime zyrtare, në vitin e kaluar kanë qenë 1,006.20€, kurse në vitin 2025 kemi 6,488.97€. Kurse, në fillim të tabelës, të shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, i kemi zero euro. Qysh mundet me pasë avanc për udhëtime jashtë vendit mbi 6 mijë euro, kurse të shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, nuk ka shpenzime.

Kodi 14023 – mirëmbajtja e shkollave, nga 996.00€, ka kaluar në 32,500.00€. Kodi 14050 – mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve, nga 12,613.99€, ka kaluar në 28,973.80€. Çfarë mobiljesh janë duke u mirëmbajtur që është rritur çmimi aq shumë?

Kodi 14160 – qiraja për automjete, zero euro ka qenë vitin e kaluar, kurse në vitin 2025 kemi 11,442.24€. A është kjo vetura e kryetarit, apo për cilat vetura bëhet fjalë?

Kodi 14410 – shpenzime-vendimet e gjykatave, zero euro ka qenë vitin e kaluar, kurse në vitin 2025 kemi 335,768.29€. Kjo me gjasë bëhet fjalë për shpenzimet që kanë dal nga kontrata kolektive në fushën e arsimit.

Kodi 13230 – mbeturinat, në vitin e kaluar kanë qenë 2,194.00€, kurse në vitin 2025 kemi 8,724.00€. Qysh ka mundësi kjo? A e ka rrit NPL “Përparimi” tarifën, apo po ua qitni që t’i merr dikush masanej? Kjo është diferencë e madhe.

Adnan Lahu, anëtar i KPF-së – drejtorin e financave nuk e fajësoj, sepse ky e paraqet gjendjen ashtu qysh është dhe shifrat që i posedon, por, megjithatë të kodi 13710 – vaji, ku kemi 9,000.00€ është një informatë shumë e mangët. Pastaj, të disa kode është shqetësuese, sepse në vend që të rriten shpenzimet, kurse fatkeqësisht janë zvogëluar. Psh. të kodi 13630-furnizime mjekësore, në vitin e kaluar kanë qenë 21,672.43€, kurse në vitin 2025 kemi 9,362.51€. Po ashtu, të kodi 14032-mirëmbajtja e rrugëve lokale, në vitin e kaluar kanë qenë 27,800.00€, kurse në vitin 2025 kemi 5,016.85€. Ta merr mendja që të gjitha rrugët lokale i kemi në rregull, kurse kurrë më kaos nuk ka qenë.

Pavarësisht kësaj, në aspektin profesional drejtor besoj që e ke paraqitur një gjendje reale faktike, përjashtimisht të disa emërtimeve të kodeve, që është dashur të jenë më të qarta për neve.

Kodi 13143 – shpenzime tjera të udhëtimit zyrtar jashtë vendit, ku në vitin 2024 kanë qenë 147€, kurse në vitin 2025 janë 2,378.00€. Ndërsa, sa interesant është të kodi 13142 – akomodimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit, në vitin 2025 janë zero. Qysh ka logjikë me qenë zero, kurse shpenzime tjera të udhëtimit zyrtar jashtë vendit i kemi 2,378.00€. Andaj, kërkoj sqarime për këto çështje, e sidomos në emërtime të kodeve. Për këto diskutime

duhet të jetë edhe kryetari i komunës i pranishëm, kurse qytetarët duhet t'i shohin këto mospërputhje të buxhetit, të cilat ne do t'i diskutojmë në seancën e kuvendit.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – edhe unë e pashë që mungon kodi për dreka zyrtare, sepse ndoshta jam bërë e tepërt duke i kritikuar për çdo vit për dreka zyrtare. Kurse, te shpenzimet tjera të udhëtimit jashtë vendit, avanci për udhëtime zyrtare, vaji, këtë vit janë rrit shumë shpenzimet. Te qiraja për automjete, ajo kërkoi sqarim se për çfarë automjesh është fjala. Ndërkaq, te investimet kapitale, raporti përveç që i ka shkronjat e imëta, ka vende që nuk shihet fare.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – ne si drejtori, me rastin e planifikimit të buxhetit dhe aprovimit të tij, jemi të obliguar ta bëjmë planin e rrjedhjes së parasë. Në bazë të planit të rrjedhjes së parasë, bëjmë edhe raportimin e planit të shpenzimeve. Sipas këtij plani, autorizues të buxhetit janë drejtorët e drejtorive. Unë si drejtor i financave e prezantojë punën e të gjithë organizatës buxhetore 644 – Komuna e Vushtrrisë. Sa u përket shpenzimeve, për disa pyetje mund të jap përgjigje, sepse është analitikë dhe janë të akomoduar nga të gjitha drejtoritë në një kod ekonomik dhe se për këtë moment është e pamundur. Lidhur me shpenzimet, ai sqaroi se shumica e obligimeve që i kemi pasur në vitin 2024 dhe që janë bartur në vitin 2025, jemi të obliguar që prioritet t'u japim shpenzimeve që kemi pasur ndaj furnitorëve. Ai tha se është një diskrepancë krahasuar me vitin paraprak, për shkak të vendimeve gjyqësore që i kemi pasur, ku shumë mjete financiare përmbaruesi na i kanë marrë nga kategoria “mallra dhe shërbime”, ku kemi pasur obligime të mëdha për t'i realizuar pagesat e tyre.

Secili shpenzim e ka kodin e vet ekonomik. Psh. rasti të vaji – në planin kontabël, ky kod ekonomik e ka këtë term, ku bëhet fjalë për vajin e veturave, gjeneratorëve, të cilët i kemi nëpër shkollë, QKMF, AMF.

Te akomodimet dhe shpenzimet jashtë vendit – trajnimet që mbahen jashtë vendit, shumë organizatorë akomodimet i paguajnë vet, kurse disa shpenzime tjera janë obligim të komunës. Pra, në këtë tremujor nuk kemi pasur shpenzime për akomodime, kurse për shpenzime jashtë vendit po.

Te shërbimet kontraktuese tjera – kemi shumë shërbime kontraktuese tjera që më duhet në forma analitike me ju informuar se çka është në pyetje.

Krahasuar me vitet e kaluara, këtë vit vendimet gjyqësore na kanë prolonguar në realizimin e shumë planeve buxhetore, të cilat i kemi pasur.

Andaj, për një pjesë të madhe të kodeve ekonomike më duhet t'ju kthej përgjigje me shkrim, sepse sot nuk mund t'u jap përgjigje.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – edhe unë po pajtohem që drejtori i financave e paraqet gjendjen ashtu siç është, sepse këto kode janë të drejtorive tjera. Por, fatkeqësia është që kryetari i komunës nuk është i pranishëm dhe akoma më keq është se as drejtori i prokurimit nuk është prezent të na jap sqarime. Ai propozoi që kryetari i komunës dhe drejtorët e drejtorive t'i kenë shpjegimet analitike në seancën e kuvendit.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – edhe unë po kërkoj që të gjithë drejtorët e drejtorive në seancë të na japin sqarime e nevojshme për këtë raport.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri me plotësime rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Bartja e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rr. "Shahin Krasniqi" në Vushtri;
5. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rr. "Isa Boletini" dhe sheshit "Hasan Prishtina" në Vushtri;
6. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rr. "Gj.K. Skënderbeu" në Vushtri;
7. Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës- ri rregullim të kufirit të pronës tek SHMU "Ali Kelmendi" në Vushtri sipas gjendjes faktike;

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – tha se këto pika veç i kemi në rend të ditës, të cilat do t'i diskutojmë.

Mentor Hasani, anëtar i KPF-së – deklaroi se për të ardhur deri te një aprovim i gjithanshëm kërkohet edhe leja e ministrisë. Drejtori e shpjegoi se për një pikë të rendit të ditës e kemi vlerësimin e ministrisë, kurse për pronat tjera janë në shqyrtim. Ne po i procedojmë në kuvend, nëse nuk e kemi vlerësimin e ministrisë deri në mbledhjen e kuvendit, këto qeveria i tërheq nga rendi i ditës.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – nuk pajtohem me arsyeimin e Mentorit, sepse kryetari i komunës ka marrë mandat t'i përfaqësojë interesat e qytetarëve dhe këto propozime i ka sjellë në kuadër të kompetencave ligjore. Prandaj, për një kryetar komune nuk ka gjë më të rëndësishme sesa territori i tij dhe sot është dashur të jetë i pranishëm në mbledhje dhe të jap sqarime. Sepse, materiali sapo erdhi dhe se e kemi vështirë ta dimë sakë për cilat parcela bëhet fjalë, cili është interesi i komunës. Këmbimi është i rregulluar me ligj dhe shpeshherë bëhet për qëllime të mira. Kryetari i komunës nuk është në nivel të detyrës. Në një parcelë thuhet shfrytëzues për 99 vite. A ka të drejtë të hyjë në këmbim të pronës derisa është shfrytëzues?

Unë i kam rezervat e mia dhe për këtë arsye do të votojë kundër derisa nuk i kam shpjegimet e duhura nga ana e kryetarit të komunës.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – kërkoj që të mos procedohen për kuvend, sepse nuk janë shpjegimet e nevojshme se cili është qëllimi i këmbimit të pronave. Është material voluminoz dhe nuk mund ta analizojmë tani për tani dhe se edhe nuk jemi ekspert të kësaj fushe që të kuptojmë këtë. Unë do të votojë kundër derisa nuk kemi shpjegime.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – prapë po them se nëse nuk e kemi vlerësimin nga ministria këto propozime nuk do të trajtohen në kuvend dhe do t'i tërheqim nga rendi i ditës.

Adnan Lahu, anëtar i KPF-së – në parim nuk po pajtohem me një çështje se sa bëhet fjalë në këtë kuvend për prona këtu bëhet kaos. Ne në parim nuk duhet të jemi kundër këmbimit apo dhënies së pronave. Pajtohem me parafolësit që materiali ka ardhur me vonesë. Ju kisha sugjeruar që pikat që kanë të bëjnë me pronat, kuvendi të jetë i informuar mirë, sepse po kemi telashe çdo herë. Ai tha se në kuvend duhet të paraqiten në një formë sa më të thjeshtë që ta kuptojnë anëtarët e kuvendit dhe të bëhet me ortofoto në projektor, se cila pjesë po i merret komunës, e cila pjesë po i ipet komunës. Kjo për shkak se në kuvend mos të kemi telashe, kurse anëtarët e kuvendit të jenë mirë informuar. Pikat tjera që nuk kanë vlerësim të ministrisë, nuk e di a bëjmë shkelje apo jo nëse i procedojmë në kuvend. Andaj, kërkojmë një sqarim nga sekretaria për këtë.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – konsideroj se nuk bëjmë shkelje ligjore nëse i procedojmë në kuvend. Nëse nuk vijnë vlerësimet nga ministria, këto nuk do të trajtohen në kuvend.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – ministria ju ka kërkuar që ta plotësoni dokumentacionin, a ja keni dërguar materialin shtesë ministrisë?

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – ne kemi komunikuar me ministria dhe kërjt çka kërkuar material shtesë ja kemi dërguar. Jemi në pritje të vlerësimit, tha ai.

Bastri Duraku, udhëheqës i Sekretarisë së Kuvendit – deklaroi se KPF-ja nuk merr vendim, por jep rekomandime. Sipas meje, kjo nuk paraqet ndonjë shkelje ligjore nëse procedohet në kuvend. Në momentin që ministria nuk jep vlerësimet, me automatizëm këto pika nuk do të trajtohen në kuvend.

Sylejman Mehollli, anëtar i KPF-së – prapë po e them që mungesa e kryetarit për tema të ndjeshme e bënë të pamundur votën “për” nga ana jonë. Këtu më shumë është interesi i këtyre njerëzve sesa i komunës.

Pas debatit për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota “për”, dy (2) vota “kundër” (Sylejman Mehollli dhe Fatmire Cecelia) rekomandoi që:

- Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rugës. “Gj.K. Skënderbeu” në Vushtrri

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim, pasi që posedon vlerësim nga ministria.

- Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rugës. “Shahin Krasniqi” në Vushtrri.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. Por, nëse deri në seancën e kuvendit nuk vjen vlerësimi nga ministria, të hiqen nga rendi i ditës.

- Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës. "Isa Boletini" dhe sheshit "Hasan Prishtina" në Vushtri.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. Por, nëse deri në seancën e kuvendit nuk vjen vlerësimi nga ministria, të hiqen nga rendi i ditës.

- Propozim-vendim për miratimin e propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private për zgjerimin e Rrugës- ri rregullim të kufirit të pronës tek SHMU "Ali Kelmendi" në Vushtri sipas gjendjes faktike.

Për këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja rekomandoi:

Që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim. Por, nëse deri në seancën e kuvendit nuk vjen vlerësimi nga ministria, të hiqen nga rendi i ditës.

8. Pyetje dhe përgjigje.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – çka po ndodhë në shesh te kalaja e qytetit? Kur dihet që afër monumenteve të trashëgimisë kulturore nuk lejohet të ndërtohet, e aq më pak pa leje të institucioneve përgjegjëse. Po ashtu, dua ta di se çka po ndodhë edhe te ura e gurit? Çka po ndodhë me fatin e asaj rruge afër urës së gurit? Makineritë e rënda që po qarkullojnë atje e rrezikojnë edhe urën e gurit.

Te rruga "Ismail Qemali" ka filluar të hapet një gropë (në ditë feste), ku po përgatitet fillimi i ndonjë punimi (afër një kafiterie, ku gjendet reklama "Buki design"). Ajo tha se është i rrezikuar edhe ky objekt, në të cilin është e vendosur reklama. Çka po ndërtohet aty? A posedon leje ndërtimore?

Objekti që u ndërtuar te furra "Ari", u tha që po bëhet rinovim, kurse aty u ndërtua objekt i ri.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se më shumë ka rekomandime direkte për kryetarin e komunës që të tërhiqen nga këto veprime me beton dhe nuk është marre me pranë gabimin. I bëj thirrje kryetarit të komunës që ta heqin urgjentisht betonin te ura e gurit dhe te kalaja. Mos të detyrohemi që të përdorim metoda tjera. Ky veprim është i gabuar dhe e ka shëmtuar atë pamje. Rruga te ura e gurit ka mundur që të largohet. Pse nuk u zhvendos më larg rruga te ura e gurit, kur ka pasur hapësirë. Është dashur të gërryhen harqet e urës dhe t'i lëshohet fryma që të duket më e madhe.

Kryetari i komunës duhet të jetë më reprezentativ i interesave të qytetarëve. Ai tha se qytetarët e Vushtrisë po vuajnë nga mungesa e ujit të pijes si pasojë e menaxhmentit të ujësjellësit. Nga informacionet jozyrtare, menaxhmenti po e redukton prodhimin e ujit, për shkak se një rregullator i ndërmarrjeve publike ju ka thënë se keni humbje të mëdha të ujit. Kryetari i komunës të jetë në nivel të detyrës dhe të bëjë presion te menaxhmenti që të mos reduktohet prodhimi dhe qytetari i Vushtrisë mos të dëmtohet, por të ketë furnizim të rregullt me ujë të pijes. Fabrika në Shipol nuk është duke bërë reduktime të ujit, por kjo po ndodh vetëm në fabrikën e Balincit.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – sqaroi se te ura e gurit në bazë të koordinatave ajo ka qenë rrugë dhe kështu figuron në kadastër. Pra, në të kaluarën aty ka qenë rruga. Kurse, te kalaja është duke investuar Posta e Kosovës.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – nëse kanë qenë mundësitë natyrore, pse nuk u zhvendos pak rruga dhe të largohet nga ura

Adnan Lahu, anëtar i KPF-së – nëse ka pasur rrugë në të kaluarën, ka mundur të jetë rrugë me kalldrëm, e dheut apo e ngjashme. Ka mundur të jetë ndonjë rrugë që nuk e ka dëmtuar arkitekturën, e as pamjen e urës së gurit. Ai tha se kemi informata jozyrtare se instituti ka qenë në komunë dhe e ka ngrit si shqetësim çështjen e punimeve të ura e gurit dhe të kalaja. Në si opozitë duhet të bëjmë çmos që të ndalohet ajo rrugë të ura e gurit. A ka nxjerr ndonjë vendim instituti për trashëgimi kulturore që ka qenë këtu. Në si anëtarë të kuvendit duhet t'i shohim këto dokumente.

Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – asnjë objekt i trashëgimisë kulturore nuk janë vetëm të opozitës. Në momentin që ndodhë cënimi i tyre, unë jam për mbrojtjen e tyre. Në kuvend kërkojmë sqarime lidhur me punimet të ura e gurit dhe të kalaja. Ish dashtë komuna, por edhe kuvend mundet që të bëjë thirrje që të bëhen hulumtime arkeologjike dhe të hapen harqet e urës e mos të mbetet historia ashtu siç kanë dashur ta shkruajnë serbët. Kur kam qenë drejtoreshë e kulturës, në Bruksel kemi intervenuar që t'i hiqet emërtimi “ura e Vojnoviqëve” dhe e kemi lënë “Ura e vjetër e Gurit”. Por, ata punojnë më shumë se na dhe prapë ja kanë kthyer emrin. Në duhet të bëjmë hulumtime arkeologjike dhe të hapen harqet dhe të tregohet e vërteta e urës. Kjo është puna jomë si kuvend-komunë. Rruga edhe mos me qenë, kemi rrugë alternative. Unë jam për mbrojtjen e monumenteve kulturoro-artistike, pavarësisht kush është në pushtet.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – nuk e dimë qysh është planifikuar ajo rrugë. Në momentin që kalon makineria e rëndë afër urës, harqet do të bien në tokë. Kurse, gurët e urës gjenden në oborrin e restorantit.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – është e palogjikshme të krahasohet rruga në atë kohë me kohën e tanishme. Në atë kohë kanë kaluar qerre me kuaj dhe aty këtu ndonjë veturë. Nëse komuna nuk ka interesim të bëjë gjurmime arkeologjike, instituti nuk lodhet. Por, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve është dashur të marrë iniciativë dhe të kërkojë nga organet kompetente që të bëhen gjurmime arkeologjike.

Mbledhja përfundoi në orën **11:50**.

Bujar Klinaku

Procesmbajtës



Melihate Basholli - Latifi

Kryesuese e KK-së dhe KPF-së